

RREGULLORJA PËR HULUMTIME SHKENCORE

Në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-135 të Republikës së Kosovës për Veprimtari Kërkimore-shkencore dhe nenit 34, paragrafi 1.14 të Statutit të Akademisë, Këshilli Akademik në mbledhjen e mbajtur me 10.10.2023, miratoi rregulloren për Hulumtime Shkencore.

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

1. Me Rregulloren për hulumtime shkencore (në tekstin e mëtejme: “Rregullore“) në Akademia Tempulli (në tekstin e mëtejme: “Akademia“), përkufizohen rregullat, procedurat dhe dokumentet e tjera shoqëruese për organizmin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të stafit akademik, hulumtues dhe studentëve komfor Statutit të Akademisë.
2. Në mënyrë specifike, me këtë Rregullore rregullohen:
 - 2.1 Aktivitetet e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe aplikative në Akademi
 - 2.2 Organizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe aplikative;
 - 2.3 Të drejtat dhe detyrimet e organeve të Akademisë dhe stafit akademik dhe hulumtues si dhe studentëve pjesëmarrës në punët kërkimore-shkencore;
 - 2.4 Komisioni për hulumtime dhe shkencë;
 - 2.5 Financimi i punës kërkimore-shkencore dhe aplikative;
 - 2.6 Procedurat e aplikimit për mbështetje të aktivitete hulumtuese;
 - 2.7 Procedura e rimbursimit të pagesave për publikime në revista dhe konferenca;
 - 2.8 Procedura e aplikimit për mbështetje për pjesëmarrje në konferenca shkencore.

Neni 2

1. Akademia bënë kërkime shkencore, punë artistike dhe aplikative me qëllime të:
 - 1.1 Zhvillimit të vazhdueshëm të procesit arsimor;
 - 1.2 Përafrimit e studentëve me kërkimet shkencore dhe me punën artistike;
 - 1.3 Vazhdimin të zhvillimit shkencor - profesional dhe artistik të mësimeve;
 - 1.4 Zgjidhjes së problemeve të industrisë.

Neni 3

Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe aplikative sipas kësaj Rregulloreje përshinë punën kërkimore-shkencore dhe aplikative, publikimin e rezultateve të punës, aftësimin e kuadrit për

punë kërkimore shkencore si dhe ngritjen profesionale të personelit akademik, shkencor dhe studentëve.

Neni 4

1. Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe aplikative përfshinë këto aktivitetet:
 - 1.1 Realizimin e hulumtimeve shkencore themelore, të avancuara dhe aplikative me qëllim të avancimit të hulumtimit shkencor dhe aplikimit të tij në fushat në të cilat vepron Akademia.
 - 1.2 Organizimi i konferencave shkencore vendore, rajonale dhe ndërkombëtare; të punëtorive dhe seminareve; hulumtimet shkencore dhe bashkëpunimin me institucionet tjera hulumtuese në vend dhe jashtë;
 - 1.3 Bashkëpunimet me partnerët e jashtëm dhe industrinë;
 - 1.4 Përgatitjen e studimeve dhe analizave laboratorike në fushat me të cilët merret Akademia;
 - 1.5 Përgatitja e ekspertizës dhe kontrolli i cilësisë së shërbimeve dhe përshtatshmërisë së përdorimit të tyre;
 - 1.6 Organizimi i seminareve për zhvillimin profesional të stafit akademik në lëmit shkencore relevante për Akademi;
 - 1.7 Veprimtarive tjera hulumtuese – shkencore në fushat që mbulohen me programet studimore në Akademi.

Neni 5

1. Në përputhje me Statutin e Akademisë, Drejtori i Akademisë së bashku në bashkëpunim me Zyrën për mbështetjen e hulumtimeve dhe kërkime shkencore janë përgjegjës për:
 - 1.1 Udhëheqjen e aktiviteteve të hulumtimit në Akademi në pajtim me misionin dhe planin strategjik;
 - 1.2 Bashkëpunimin ndërkombëtar shkencor;
 - 1.3 Hartimin e planit vjetor të Akademisë për punë kërkimore-shkencore së bashku me buxhetin vjetor për hulumtim shkencor;
 - 1.4 Ndarjen e mjeteve të nevojshme për realizimin e veprimtarisë hulumtuese;
 - 1.5 Koordinimin dhe prioritetet e planit dhe aktiviteteve të propozuara hulumtuese shkencore

Neni 6

Zyra për mbështetjen e kërkimeve shkencore

1. Veprimtaria hulumtuese në Akademi duhet të koordinohet nga Zyra për mbështetjen e kërkimeve shkencore dhe Drejtori i Akademisë.
2. Zyra për mbështetjen e kërkimeve shkencore është përgjegjëse për:
 - 2.1 Organizimin e konferencave, punëtorive, seminareve apo forumeve shkencore
 - 2.2 Botimin e revistave shkencore;
 - 2.3 Përkrahjen e zhvillimit shkencor të stafit akademik;
 - 2.4 Koordinimin dhe monitorimin e projekteve hulumtuese;
 - 2.5 Përkrahjen e aplikimeve për projekte hulumtuese të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare;
 - 2.6 Mirëmbajtjen dhe përditësimin e seksionit për hulumtim të Webfaqes së Akademisë;

2.7 Koordinimin e bazës së të dhënave për hulumtim.

Neni 7

Përgjegjësitë e stafit akademik

1. Secili mësimdhënës në Akademi, është i obliguar që të publikoj aktivitetet e tyre shkencore në revista ndërkombëtare dhe atë mesatarisht nga një punim në vit në tri vitet e fundit.
2. Publikimet duhet të bëhen në revistat e indeksuara sipas rregullores për rekrutimin dhe avancimin e stafit Akademik të nxjerrë nga Këshilli Akademik.
3. Stafi akademik është përgjegjës për aktivitetet individuale kërkimore-shkencore dhe aplikative. Për për të arriturat e tyre janë të obliguar të njoftojnë zyrën për mbështetjen e kërkimeve shkencore dhe të raportojnë në Këshill Akademik.

Neni 8

Në nivel të programeve përgjegjës për aktivitetet kërkimor-shkencore dhe aplikative janë Koordinatorët e programeve dhe Këshilli Akademik.

Neni 9

Komisioni për hulumtime dhe shkencë

1. Komisioni për hulumtim dhe shkencë është organi përgjegjës për menaxhimin dhe përkrahjen e aktiviteteve hulumtuese në Akademi dhe përbëhet nga:
 - 1.1 Drejtori i Akademisë si kryesues;
 - 1.2 Tre anëtar të stafit akademik me Dr. Sc., me përvojë të dëshmuar në fushën e hulumtimeve shkencore;
 - 1.3 Një përfaqësues i studentëve i deleguar nga Parlamenti studentor i Akademisë;
 - 1.4 Zyrtari i për mbështetjen e kërkimeve shkencore.

Neni 10

Detyrat e Komisionit për hulumtime dhe shkencë

1. Komisioni për hulumtime dhe shkencë ka këto detyra:
 - 1.1 Propozoj Këshillit Akademik revistat individuale dhe platformat (databazat) e revistave shkencore për publikimet e stafit akademik;
 - 1.2 Propozoj Këshillit Akademik ndryshimet në rregulloren e hulumtimeve shkencore;
 - 1.3 Aprovoj apo refuzoj kërkesat për përkrahje të aktiviteteve shkencore të stafit akademik;
 - 1.4 Aprovoj apo refuzoj mbulimin e shpenzimeve të botimit të punimeve shkencore të stafit akademik në revista shkencore ndërkombëtare;
 - 1.5 Aprovoj apo refuzoj kërkesat e stafit akademik për mbulimin e pjesëmarrjes në konferenca, simpoziume, punëtori apo forume shkencore ndërkombëtare;
 - 1.6 Organizimin e konferencave, simpoziumeve, punëtorive po forumeve shkencore në Akademi.

Neni 11

Financimi i punës kërkimor-shkencore

1. Financimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore bëhet nga buxheti i Akademisë për kërkime shkencore si dhe nga pjesëmarrja e partnerëve dhe donatorëve të jashtëm bashkëpjesëmarrës në projekte të përbashkëta.
2. Buxheti për hulumtime shkencore përfshin 1000 euro për vit për secilin staf akademik dhe mbulon:
 - 2.1 Projektet hulumtuese të Stafit Akademik;
 - 2.2 Pjesëmarrja në konferenca shkencore ndërkombëtare;
 - 2.3 Botimi i punimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare;
 - 2.4 Shpenzimet për bashkëfinancim për pjesëmarrje në projekte hulumtuese rajonale dhe ndërkombëtare, etj..
3. Lartësia e mjeteve financiare për veprimtari kërkimore-shkencore caktohet me buxhetin e Akademisë, të miratuar nga Këshilli Drejtues.

Neni 12

Procedura e rimbursimit të pagesave për publikime

1. Autori e dërgon kërkesën për rimbursim pranë komisionit për hulumtime shkencore jo më larg se 30 ditë nga dita e publikimit të punimit.
2. Komisioni për hulumtime shkencore bën shqyrtimin e kërkesës duke përfshirë edhe verifikimin e kriterëve të publikimit.
3. Pas vendimit të Komisionit për hulumtime shkencore, Sekretarja e Përgjithshme është përgjegjëse për procedurat e mëtutjeshme.

Neni 13

Procedura për rimbursimin e pjesëmarrjes në konferenca shkencore

Stafi akademik i cili shpreh interesim të merr pjese në ndonjë konference, simpozium, punëtori apo kongres të karakterit shkencor duhet të bëjë kërkesë për rimbursimin e pjesëmarrjes pranë Komisioni për hulumtime shkencore për aprovim paraprak.

Neni 14

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja për hulumtime shkencore nr. 04/20, dt. 04.12.2020

Kryesuesi i Këshillit Akademik

Dr.Sc.Mevlan Bixhaku

